

Biografi e shkurtër

Melinda Pacolli, 38 vjeçe, nga Prishtina, e martuar, nënë e tre djemve të mrekullueshëm. Me mbi trembëdhjetë vjet bagazh profesional, përvoja e Melindës në ofrimin e konsulencës digjitale dhe zgjidhjeve për NVM-të është kurorëzuar edhe me titullin PhD në implementimin e sistemeve ERP në NVM si dhe me Certifikatën e Ekspertit të Transformimit Digjital poashtu. Ajo ka punuar në Itali, Zvicër, Maqedoni dhe së fundmi në Kosovë. Ajo në fakt drejtoi dhe implementoi shumë projekte të digjitalizimit për klientët nga industri të ndryshme si, prodhimi i tullave prej balte, shitja me shumicë dhe distribuim, Mbushja dhe ambalazhimi i ujit, prodhimi i djathit, përpunimi i frutave, moda dhe tekstili, shëndetësi dhe farmaci, arsimit i lartë, industria e naftës dhe derivateve, hotelieri, zinxhirët e shitjes me pakicë, etj, duke përfshirë shumë njësi të bizneseve ose edhe shumë kompani për një klient.

Pas pesë viteve të studimeve pasuniversitare dhe përvojës së punës në Evropë, motivimi i saj kryesor për t'u kthyer në Kosovë në vitin 2011 ishte që të ndihmojë NVM-të rajonale drejt procesit të digjitalizimit, përfshirë këtu edhe ri-inxhinierimin e proceseve të biznesit por edhe implementimin e teknologjive më inovative. Pas një përvoje shumë të pasur dhe hulumtimeve të shumta për Digjitalizimin e NVM-ve, në fillim të vitit 2020 libri i saj, "Përvojat e Transformimit të Suksesshëm Digjital" u botua nga një shtëpi botuese gjermane, Lambert Academic Publisher.

Aktualisht, Melinda punon si Specialiste e Digjitalizimit në projekte për dy institucione të mëdha publike Kosovare, dhe gjithashtu si Profesoreshë në Shkencat Kompjuterike, Kolegji Riinvest dhe në Programin e Shkencave të të Dhënave, në UoL me drejtimin akademik nga London School of Economics.